




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-2216/14
Dep. 2-D/DPK	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 16.06.2014
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11) të Rregullores nr.02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.06.2014, nxjerr këtë :

V E N D I M

Mbyllët rasti me nr. AKK-03-3259/13, për ztr. Novica Sosiç ish këshilltar Komunal në Komunën e Parteshit, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi që zyrtari nuk ushtron me funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3259/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, ztr. Novica Sosiç anëtar i Kuvendin Komunal të Komunës së Parteshit.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, ka mbaruar ushtrimin e funksionit publik, si këshilltar komunal i komunës së Parteshit, mirëpo kemi dyshuar se zyrtari akoma është duke ushtruar funksionin publik, pasi që kemi pasur probleme teknike dhe na kanë munguar provat për ta vërtetuar situatën, pasi që zyrtari kontaktues nga komuna e Parteshit nuk ka bashkëpunuar me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nuk ka ofruar listën e zyrtareve të lartë publik, pastaj jemi munduar që të kontaktojmë drejt me zyrtarin e

dyshuar dhe kemi arritur ta kontaktojmë zyrtarin dhe gjate bisedës ka shprehur vullnetin që të vij në Agjenci dhe të sqaroj gjendjen.

Ztr. Novica Sosiç, ka ardhur në Agjenci dhe është takuar me zyrtarët e Agjencisë, gjate takimit që është mbajtur me zyrtarin në fjalë, zyrtarët e AKK-së e kanë njoftuar me situatën lidhur me dyshimin për konfliktin të mundshëm të interesit në ushtrim të funksionit publik, zyrtari në fjalë pasi që ka marrë edhe informatat në mënyrë verbale, është pajtuar, së ka qenë zyrtar, mirë po ka potencuar se nuk e ushtron me funksionin publik ku dhe ka dëshmuar se nuk është me zyrtar publik.

Ndërsa Agjencia me datën 04.06.2014, ka siguruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, listën e zyrtarëve të lartë Publik nga komuna Parteshi (AKK-DPK-03-2049/14).

Andaj konsiderojmë se pasi që personi ztr. Novica Sosiç, nuk gjendet në listën e zyrtarëve të lartë të siguruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në komunën e Parteshit nuk kemi prova për ta vazhduar trajtimin e lëndës të iniciuar për gjendje të konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

